

VENDIM
Nr. 274, datë 1.4.2015

PËR NDRYSHIMIN E PËRGJEGJËSISË SË ADMINISTRIMIT, NGA MINISTRIA E KULTURËS TE MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME, TË OBJEKTIT “POSTA E POLICISË KUFITARE, KSAMIL”, PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 12, DATË 4.1.2012, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, DHE PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 250, DATË 24.4.2003, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit, nga Ministria e Kulturës te Ministria e Punëve të Brendshme, të objektit “Posta e Policisë Kufitare, Ksamil”, me numrat rendorë 107, 108, 109 e 110, sipas formularit bashkë-lidhur këtij vendimi.

2. Prona e përmendur në pikën 1, të këtij vendimi, të shtohet në listën e inventarit të pronave shtetërore, që i bashkëlidhet vendimit nr. 250, datë 24.4.2003, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Rendit Publik”, të ndryshuar.

3. Në titull dhe në pikën 1, të vendimit nr. 12, datë 4.1.2012, të Këshillit të Ministrave, “Për ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit, nga Ministria e Brendshme te Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, të objekteve “Posta e Policisë Kufitare, Vivar”, Sarandë, dhe “Posta e Policisë Kufitare, Ksamil”, togfjalëshi “Posta e Policisë Kufitare, Ksamil” shfuqizohet.

4. Ngarkohen Ministria e Kulturës, Ministria e Punëve të Brendshme dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

3.FORMULAR PER INVENTARIZIMIN E PRONAVE TE PALUAJTSHME SHETERORE

(Te tipit te pronave qe inventarizohen si kalasa te vecanta)

Institucioni i Pushtetit Qendror MRP (Komisariati Policise Sarande)		Identifikimi:	
Bashkia : Komuna Ksamil		Grupi i Punës	
Fusha e perdomrit te Prones : Ruajtje Rendi		Shef Sek Administrim Prones Y Myslimaj	
		Spec. Ing.L. Shkupi	
		Spec. Ing.A. Halilvaxhiu	
		Supervizori:	
		Miratoi : Ministri i Rendit Publik Z. Luan Rama	

Nr. Rendi	A		Emertesa e pronës Vendi ndodhja / Shtrirja Gjeografike	B		Përmasat e pronës me m2 ose ml	C			Te dhëna të tjera (Shënime të veçanta)
	Zona Kadast Indeksi Hartes	Nr. Pasurisë		Komponentet Përbërësit Pronës	Adresa/vendi ndodhja e komponenteve përbërës		Funksioni për të cilin përdoret Prona	Institucioni / Enti me përgjegjësi administrative	Institucioni/Enti përdorues Statusi juridik i përdorimit	
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
107			Posta e Kufirit Ksamil	Truall Total		800				Ardhur Me shkresën Nr.892 Dt.13.07.2002
108				Godina Kryesore	Pike Referimi	210	Ambiente pune Zyra	MRP	Kom.Pol. Sarandë	
109				Tualet	Vendi-Përendim	17	Tualet	MRP	Kom.Pol. Sarandë	
110				Kulle vrojtimi	Vendi-Lindje	20	Kulle vrojtimi	MRP	Kom.Pol. Sarandë	
111			Posta e Kufirit Vivar	Truall Total		280				
112				Komanda	Pike referimi	228	Ambiente pune	MRP	K.P Sarandë	E demtuar
113				Tualet/lavateri	Jug	23	Tualet	MRP	K.P Sarandë	
114				Depo uji	Vendi-Përendim	12	Depo	MRP	K.P Sarandë	
115				Kuzhine	Vendi	16	Depo	MRP	K.P Sarandë	